URDHRI I STOMATOLOGUT TË SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR

Nr. 484 Prot. Tiranë, më 19.12.2025

VENDIM

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES "*PËR REGJISTRIMIN, LIÇENSIMIN DHE ANËTARËSIMIN NË USSH*"

Në zbatim të ligjit nr. 127/2014 "*Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë*", nenit 11, pika 2, shkronja "g", nenit 17, pika 2 të Statutit të Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë, Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë, në mbledhjen e tij të datës 19.12.2025 me votim unanim pa asnjë votë kundër,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "*Për Regjistrimin, Liçensimin dhe Anëtarësimin në USSH*", formës së liçensës për ushtrimin individual të profesionit të stomatologut, formës së liçensës së Drejtuesit Teknik dhe dokumenteve standarde sipas tekstit dhe anekseve që i bashkëngjitet këtij vendimi.
2. Të gjitha vendimet e mëparshme për miratimin dhe ndryshimin e rregullores "*Për Regjistrimin, Liçensimin dhe Anëtarësimin në USSH*", formës së liçensës për ushtrimin individual të profesionit të stomatologut, formës së liçensës së Drejtuesit Teknik dhe dokumenteve standarde shfuqizohen.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Urdhri i Stomatologut të Shqipërisë, si dhe urdhrat rajonalë të stomatologëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I KËSHILLIT KOMBËTAR

Dr. Almiro Gurakuqi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË URDHRI I STOMATOLOGUT KËSHILLI KOMBËTAR